MANUAL PËRDORUESI PËR SUBJEKTET

Aplikimi nga portali e-Albania (Barnat)

Përmbajtja

1. Hyrje 3
1.1 Rreth manualit të përdoruesit 3
1.2 Modulet e përfshira 3
1.3 Supozime 3
2. Aplikimi për autorizim importi nëpërmjet portalit e-Albania 4
3. Aplikimi për autorizim zhdoganimi nëpërmjet portalit e-Albania 8

1. Hyrje

Mirë se vini në manualin e përdoruesit për aplikimin për autorizim importi dhe autorizim zhdoganimi nga portali e-Albania.

1.1 Rreth manualit të përdoruesit

Ky manual përfshin të gjithë informacionin e nevojshëm për përdorimin e shërbimeve, gjithashtu përmban informacion të detajuar për sa vijon:

• Përmbledhje dhe informacion referimi.

• Informacion të detajuar për aplikimin për autorizim importi për barnat e pajisura me autorizim tregtimin në Republikën e Shqipërisë.

• Informacion të detajuar për aplikimin për autorizim zhdoganimi për barnat e pajisura me autorizim importi.

1.2 Modulet e përfshira

Ky manual është burimi kryesor i informacionit në lidhje me aplikimin nga portali qeveritar e-Albania për autorizim importi dhe autorizim zhdoganimi. Përmban përmbledhje, si dhe detyra dhe informacion referimi. Manuali përfshin kapitujt e mëposhtëm:

Moduli 1, Aplikimi për autorizim importi nëpërmjet portalit e-Albania: Përshkruan se si subjekti mund të aplikojë nga portali qeveritar e-Albania për autorizim importi, se si mund të gjurmohet aplikimi dhe se si mund të gjenerohet autorizimi i importit me vulë elektronike.

Moduli 2, Aplikimi për autorizim zhdoganimi nëpërmjet portalit e-Albania: Përshkruan se si subjekti mund të aplikojë nga portali qeveritar e-Albania për autorizim zhdoganimi, se si mund të gjurmohet aplikimi dhe se si mund të gjenerohen autorizimi i zhdoganimit dhe autorizimi i përdorimit me vulë elektronike.

1.3 Supozime

Ky udhëzues supozon që ju keni njohuri pune të parimeve dhe praktikave të zakonshme të procesit të pajisjes me autorizim importi dhe autorizim zhdoganimi.

2. Aplikimi për autorizim importi nëpërmjet portalit e-Albania

Hapi	Veprimi
1.	Importuesi i autorizuar nga kompanitë mbajtëse të autorizimit të tregtimit (këtu e në vijim **aplikanti**) aplikon nga portali e-Albania për: - **Autorizim importi** për barna të pajisura me autorizim tregtimi në Republikën e Shqipërisë dhe gjenerim autorizimi importi me vulë elektronike
2.	Identifikohuni si biznes në portalin e-Albania 
3.	Kërkoni dhe zgjidhni nga lista e shërbimeve, shërbimin "**Aplikim për autorizim importi**".
4.	Klikoni butonin "Krijo aplikim të ri" për të aplikuar për autorizim importi 

Hapi	Veprimi
5.	Zgjidhni tipin e aplikimit 
6.	Hapet formulari elektronik i autorizimit të importit ku ju duhet të plotësoni të dhënat sipas seksioneve.
6.a	 Në seksionin A: Të dhënat e aplikantit, të dhënat si NIPT i subjektit, Emri i subjektit, Adresa e subjektit, Nr Tel dhe Email plotësohen automatikisht nëpërmjet ndërveprimit me Regjistrin Tregtar të QKB-së. Gjithashtu kontrollohet nëse subjekti ka licensë të vlefshme. Plotësoni fushën Qyteti.

Hapi	Veprimi
6.b	 Në seksionin B: Të dhënat e aplikimit plotësoni fushat  Valuta duke zgjedhur nga lista valutën; Importuesi duke zgjedhur nga lista importuesin; Numri i faturës me numrin e faturës së importit; Data e faturës duke zgjedhur nga kalendari datën e faturës së importit; Dogana duke zgjedhur nga lista doganën; Koment nëse keni komente apo informacion mbi autorizimin e importit për të cilin po aplikoni.
6.c	 Në seksionin C: Barnat klikoni butonin "Shto bar" për të shtuar barin që do të pajiset me autorizim importi. Në dritaren që hapet Shto bar  Plotësoni fushat Bari, Prodhuesi dhe Paketimi duke zgjedhur nga listat respektive, Numri i serisë, Data e prodhimit, Data e skadimit, Sasia dhe Cmimi CIF. Klikoni butonin "Shto"për të shtuar barin respektiv. ***<u>Shënim: Ju mund të shtoni më shumë se një bar.</u>***

Hapi	Veprimi
6.d	 Në seksionin D: Dokumentat e aplikimit ngarkoni dokumentat e kërkuara për tu pajisur me autorizim importi: ❑ ***Fatura (Incvoice/Proforma Invoice)***, ❑ Dokumenta ***të tjera***.
7.	Pas plotësimit të formularit elektronik për pajisjen me autorizim importi dhe ngarkimit të dokumentave të kërkuara, plotësoni ☑ për të pranuar kushtet e përdorimit dhe në fund shtypni butonin "Dërgo" për të dërguar aplikimin.
8.	Pas shtypjes së butonit "Dërgo", në ekran do ju shfaqet mesazhi për kryerjen me sukses të aplikimit dhe numri i gjurmimit  Aplikimi pajiset me një numër gjurmimi në mënyrë që aplikanti të kontrollojë se në cilën fazë ndodhet shqyrtimi i aplikimit. Gjithashtu aplikanti njoftohet te **Mesazhet e mia**.
9.	Ju do të njoftoheni te seksioni "**Mesazhet e mia**" në e-Albania për dokumentacionin shtesë që duhet të plotësoni, aprovimin/refuzimin e aplikimit.
10.	Në rastet kur kërkohet nga AKBPM-ja, plotësoni dokumentacionin e kërkuar nga portali e-Albania duke ngarkuar dokumentat respektivë.
11.	Pas aprovimit nga personat përgjegjës, Ju do të pajiseni me autorizim importi të vulosur elektronikisht, duke u njoftuar te seksioni "**Dokumentet e mia**" në portalin e-Albania.
12.	**Fundi i procedurës.**

3. Aplikimi për autorizim zhdoganimi nëpërmjet portalit e-Albania

Hapi	Veprimi
1.	Importuesi i autorizuar nga kompanitë mbajtëse të autorizimit të tregtimit (këtu e në vijim **aplikanti**) aplikon nga portali e-Albania për: - **Autorizim zhdoganimi** dhe gjenerim autorizimi zhdoganimi me vulë elektronike
2.	Identifikohuni si biznes në portalin e-Albania 
3.	Kërkoni dhe zgjidhni nga lista e shërbimeve, shërbimin "**Aplikim për autorizim zhdoganimi**".
4.	Klikoni butonin "Krijo aplikim të ri" për të aplikuar për pajisjen me autorizim zhdoganimi 
5.	Shfaqet lista e autorizimeve të importit me të cilat është pajisur aplikanti.

Hapi	Veprimi
6.	Zgjidhni nga lista e shfaqur autorizimin e importit 
7.	Hapet formulari elektronik i paraplotësuar paraprakisht 

Hapi	Veprimi
7.a	 Në seksionin D: Dokumentat e aplikimit ngarkoni dokumentat e kërkuara për tu pajisur me autorizim zhdoganimi: ❑ **Autorizimin e importit nga AKBPM-ja**; ❑ **Invoice**; ❑ **Packing List**; ❑ **Çertifikatat e analizës për çdo bar në autorizimin e importit**; ❑ **Çertifikatën e origjinës ose Euro1.**
8.	Pas ngarkimit të dokumentave të kërkuara, plotësoni ☑ për të pranuar kushtet e përdorimit dhe në fund shtypni butonin "Dërgo" për të dërguar aplikimin.
9.	Pas shtypjes së butonit "Dërgo", në ekran do ju shfaqet mesazhi për kryerjen me sukses të aplikimit dhe numri i gjurmimit  Aplikimi pajiset me një numër gjurmimi në mënyrë që aplikanti të kontrollojë se në cilën fazë ndodhet shqyrtimi i aplikimit. Gjithashtu aplikanti njoftohet te **Mesazhet e mia**.
10.	Ju do të njoftoheni te seksioni "**Mesazhet e mia**" në e-Albania për dokumentacionin shtesë që duhet të plotësoni, aprovimin/refuzimin e aplikimit.
11.	Në rastet kur kërkohet nga AKBPM-ja, plotësoni dokumentacionin e kërkuar nga portali e-Albania duke ngarkuar dokumentat respektivë.

Hapi	Veprimi
12.	Pas aprovimit nga personat përgjegjës, Ju do të pajiseni me autorizim zhdoganimi të vulosur elektronikisht, duke u njoftuar te seksioni "**Dokumentet e mia**" në portalin e-Albania.
13.	Në rastet kur kërkohet nga AKBPM-ja, plotësoni dokumentacionin e kërkuar të nevojshëm për gjenerimin e autorizimit të përdorimit.
14.	Pas shqyrtimit nga personat përgjegjës, Ju do të pajiseni me autorizim përdorimi të vulosur elektronikisht duke u njoftuar te seksioni "**Dokumentet e mia**" në portalin e-Albania.
15.	**Fundi i procedurës.**